



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 59, datë 28.03.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 181, datë 06.10.2021, së z. N.G., ku pretendohet diskriminim për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar², nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesi N.G., i datëlindjes 23.11.1950, me vendbanim në Patos, Fier, me profesion teknik i mesëm, mekanik, ka dalë në pension pleqërie në vitin 2015, pas 44 vitesh e 11 muajsh, vjetërsi në punë, përfshirë këtu edhe disa vite invaliditeti. Ankuesi pretendon se puna, që ai ka kryer gjatë këtyre viteve ka qenë naftëtar dhe se i përket kategorisë 7 + 15% shkallë vështirësie, pasi ka punuar në pusët e naftës nga Velipoja e deri në Bogaz të Sarandës. Për arsye shëndetësore, nga viti 2003 deri në vitin 2015, ankuesi është shkëputur nga puna, pasi ka gëzuar statusin e invalidit të punës.

Në vitin 2015, pensioni i tij është llogaritur në shumën 21.000 lekë. Në kushtet kur, z. N.G. ka qenë i paqartë mbi përlllogaritjen e pensionit të tij, në datën 27 maj 2021, i është drejtuar me kërkesë me shkrim, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, ku i është kërkuar informacion mbi pasqyrën e llogaritjes së pensionit të tij, si dhe mbi shtesën e statusit të

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Referuar kopjes së Dëshmisë së Invaliditetit nr. 128, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës, ankuesi është invalid i pjesshëm. Referuar Dëshmisë së sipërcituar, vendimi i KMCAP-së është i vlefshëm deri në datën 30.09.2022;

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin “DRSSH Fier”;

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

naftëtarit, për të cilin ankuesi ka aplikuar në muajin korrik 2019. Ai pretendon se këtë shtesë mbi pension e kanë përfituar edhe punonjës të tjerë të ndërmarrjes, ku ai ka punuar.

Z. N.G. sqaron se DRSSH Fier ka dërguar shkresën nr. 8910 prot., datë 28.09.2021, nëpërmjet së cilës, ai ka marrë dijeni mbi faktin se masa e pensionit të tij është llogaritur me koeficientin minimal dhe jo atë maksimal, pavarësisht vështirësisë në punë.

Për këtë arsye, ai kërkon të kryhet një rivlerësim i masës së pensionit, si dhe të bëhet ballafaqimi i borderove me librezën e punës, duke caktuar ekspertë kontabël, që të kryejnë ekspertizat përkatëse mbi vitet e punës dhe vështirësive, që i takojnë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 181, datë 06.10.2021, së z. N.G., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua DRSSH Fier dhe për dijeni ankuesit, me shkresën nr. 1405/1 prot., datë 14.10.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - 1.** Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 - 2.** Kopje e librezës së punës së ankuesit.
 - 3.** Pasqyrë e periudhave të punësimit, mbi bazën e së cilave është kryer përlllogaritja e pensionit të z. N.G.;
 - 4.** Informacion mbi mënyrën se si është përlllogaritur pensioni i ankuesit dhe koeficienti i përdorur për të kryer këtë përlllogaritje. Si është përcaktur ky koeficient për rastin e ankuesit?
 - 5.** Informacion mbi mënyrën se si është përlllogaritur pensioni i pleqërisë, për periudhën që ankuesi ka qenë invalid i pjesshëm pune;
 - 6.** Informacion nëse ankuesit i është llogaritur në pension shtesa për statusin e naftëtarit;
 - 7.** Kopje të korrespondencës zyrtare me ankuesin;

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar së KMD-së, DRSSH Fier dërgoi shkresën nr. 9498/1 prot., datë 25.10.2021, nëpërmjet së cilës informon se pensionisti N.G., është i datëlindjes 23.11.1950 dhe me Vendimin nr. 4361, datë 18.12.2015, DRSSH Fier i ka caktuar pension pleqërie, për periudhën e sigurimit 44 vite e 11 muaj. Baza fillestare e vlerësuar mbi të cilën është llogaritur pensioni është 27777 lekë. Pensioni është në masën fillestare 21067 lekë, me të drejtë pagese prej datës 23.11.2015.

Në llogaritjen e pensionit janë përfshirë disa periudha të vjetërsisë, në punë duke filluar me periudhën 21.11.1970 – 16.11.1973 përgjatë së cilës ankuesi ka kryer shërbimin ushtarak, që është vlerësuar me pagën referuese b6 - specialist në ndërmarrje, në shumën 3288 lekë. Në vijim, rezulton periudha 01.06.1966 – 31.08.1966, përgjatë së cilës ankuesi ka punuar pranë NMSH Prodhim Marinëz, që është vlerësuar me pagën referuese “c4 nafta”, në shumën 3288 lekë. Periudha vijuese është 03.09.1970 – 18.11.1970, ku z. N.G. ka punuar si teknik mekanik/NSHNI, që është vlerësuar me pagën referuese b6-specialist në ndërmarrje, në shumën 3288 lekë. Periudha pasardhëse konsiston prej datës 01.06.1974 - 31.12.1981, ku ankuesi ka punuar teknik mekanik/NBT dhe që është vlerësuar me pagën referuese b6-specialist në ndërmarrje, në shumën 3288 lekë. Periudha vijuese i përket datave 01.01.1982-26.02.1993, ku ankuesi ka qenë punësuar pranë NRFISH, vlerësuar me pagën referuese “c4 nafta” në shumën 3288 lekë. Në vijim, për periudhën 26.02.1993-31.08.2003, masa e pensionit është vlerësuar me pagën referuese b6, atë të specialistit në ndërmarrje, në vlerën 3288 lekë dhe prej datës 01.01.1994 me pagat mbi të cilat është paguar kontributi i sigurimeve shoqërore. Në pensionin e pleqërisë është vlerësuar edhe periudha përgjatë datave 01.09.2003-23.11.2015, kur ankuesi N.G. ka qenë invalid i pjesshëm.

Pensionin është llogaritur me koeficientët e vitit 2015 dhe masa e tij është llogaritur në bazë të nenit 32, të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: “ Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. 2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. 3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit siguri shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji; 4. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social”. DRSSH Fier sqaron se shuma bazë është 8585 lekë + llogaritja e shtesës 12481= masa e pensioni 21067 lekë.

Z. N.G. ka aplikuar për pension suplementar (naftë dhe pleqëri) konform ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, nëpërmjet kërkesës nr. 359 regj., datë 11.09.2019. Me shkresën nr. 2172 prot., datë 19.02.2021, DRSSH Fier i ka kthyer përgjigje negative ankuesit, pasi ai nuk plotëson kushtin e vjetërsisë, sipas nenit 6, gërma b) të ligjit nr. 29/2019, ku caktohet se shtesën mbi pension e përfitojnë të gjithë personat që kanë jo më pak se 6 vite punë, profesione apo detyra sipas përcaktimeve në Vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, i ndryshuar, Vendimin nr. 447, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave “Për

emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në Vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”, si dhe Vendimit nr. 448, datë 03.06.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”.

Sipas vërtetimit të posaçëm zyrtar nr. 7026 prot., datë 19.02.2020, rezulton se periudha e punës e njohur sipas VKM nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, i ndryshuar dhe dy VKM-ve të sipërcituara është 01.06.1966 – 31.08.1966, pranë N.M.Sh. Prodhimi Marinëz, në pozicionin e punës pompist.

DRSSH Fier sqaron se periudhat e papërcaktuara sipas të 3 (tre) VKM-ve të sipërcituara janë:

- Ndërmarrja Baza e Tubove Patos – 01.06.1974-31.12.1981, në pozicionin Teknik Mekanik;
 - N.R.F.I.SH Fier – 01.01.1982 – 08.02.1984 – në pozicionin Difektoskopist;
 - N.R.F.I.SH Fier – 09.02.1984 – 08.05.1984 – në pozicionin Ndjekës Komploti;
 - N.R.F.I.SH Fier – 09.05.1984 – 26.02.1993, në pozicionin Kontrollor Kanterial;
 - N.R.F.I.SH Fier – 27.02.1993 – 30.05.1998 – në pozicionin Brigadier Kontrollor;
 - N.R.F.I.SH Fier – 01.06.1998 – 31.08.2002- në pozicionin Specialist Kontrollor i Brendshëm;
- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 1405/3, datë 06.12.2021, së KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 07.01.2022, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi, i cili kërkoi para KMD të përfaqësohej nga vajza e tij, znj. B.G., si dhe përfaqësuesja me autorizim e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Ankuesi parashtroi edhe një herë pretendimet e tij lidhur me objektin e ankesës. Ai sqaroi se është naftëtar në pension dhe invalid i pjesshëm pune prej vitit 2003. Para këtij viti, ai ka punuar në fushën e naftës dhe ka eksperiencë të konsiderueshme pune. Ai u shpreh se ka filluar punë në vitin 1974. Në vitin 1975, ai ka mbajtur pozicionin e kontrollit. Në vitin 1999, është caktuar si invalid i pjesshëm pune me vendim të KMCAP. Ndërmarrja e Tubove Fier, ku ai ka punuar nga viti 1974-1981, nuk përfshihej në listën e ndërmarrjeve të përcaktuara nga aktet nënligjore, punonjësit e të cilave përfitonin nga statusi i naftëtarit. Ai shprehet se pas 45 vitesh vjetërsie në punë, ai ka dalë në pension në vitin 2015. Lidhur me çështjen e masës së pensionit, ai shprehet se është i paqartë mbi mënyrën se si janë kryer llogaritjet nga ana e DRSSH Fier, lidhur me periudhën kohore përgjatë së cilës ka kryer shërbimin ushtarak, periudhës kohore 1974-1981, kur ai ka punuar pranë Ndërmarrjes së Tubove të Naftës Fier, si dhe gjatë periudhës kur i ka filluar statusi si invalid i pjesshëm pune përgjatë periudhës 2003-2015. Lidhur me çështjen e fundit, ai sqaron se koeficienti i përdorur për llogaritjen e masës së pensionit nuk ka qenë i duhuri.

Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën ankuesin nëse kishte informacion për kolegë të tij, që kanë kryer të njëjtën punë me të, lidhur me masën e pensionit të përfituar nga ana e tyre, në kushtet kur pretendohet diskriminim për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar. Ankuesi u përgjigj se ata kanë ndërruar jetë dhe nuk e kanë përfituar pensionin.

Përfaqësuesja e DRSSH Fier sqaroi fillimisht se masa e pensionit për shërbimin ushtarak llogaritet në bazë të vërtetimit të dërguar nga ministria përgjegjëse dhe ky është një përcaktim ligjor, i cili zbatohet për të gjithë. Vërtetimi i dërguar nga Ministria përgjegjëse përcakton se ankuesi ka kryer shërbimin ushtarak, pa përcaktuar faktin se ai ka punuar motorrist gjatë këtij shërbimi. Periudha e shërbimit ushtarak i është llogaritur sipas kategorisë B6. Lidhur me statusin e naftëtarit, përfaqësuesja e DRSSH Fier sqaroi se ankuesi nuk e përfiton ligjërisht këtë status, pasi kriteri ligjor për përfitimin e tij është që punonjësi duhet të ketë përvojë pune në sektorin e naftës minimalisht 6 vjet. Ankuesi nuk e përmbush këtë kriter. Ajo sqaroi se përgjatë periudhës kohore 1974-1981 ankuesi ka punuar në pozicionin e punës teknik mekanik pranë Bazës së Tubove Fier. Ai nuk mund të përfitonte nga shtesa për pension për statusin e naftëtarit, pasi ndërmarrja ku ai ka punuar nuk përfshihej në listën e ndërmarrjeve që e përfitonin këtë status. Ajo theksoi faktin se në librezën e punës së ankuesit është vënë një shënim në fund të faqes, që ai ka punuar edhe në pozicionin e punës difektoskopist pranë ndërmarrjes së sipërcituar, ndërkohë që në bordero dhe regjistrat përkatës të administruar në arkivën e DRSSH Fier, ai rezulton se ka punuar në pozicionin e punës teknik mekanik. Lidhur me periudhën kohore 2003-2015 përgjatë së cilës, ankuesi ka qenë invalid i pjesshëm pune, ajo sqaroi se koeficienti i përlllogaritjes ka qenë ai i vitit 2015, koeficient ky që ka qenë më i madh se paraardhësit, pasi koeficientët pësojnë rritje ndër vite.

Në seancë u sqarua se çështja lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së masës së pensionit të ankuesit përgjatë viteve ishte një çështje e cila duhet të gjente fillimisht zgjidhje pranë gjykatës kompetente. Pavarësisht kësaj, Komisioneri do ta shqyrtonte brenda kompetencave që atij i atribuon LMD, i ndryshuar. Znj. B.G. u shpreh se kjo çështje do të dërgohej për shqyrtim gjyqësisht, ku në të njëjtën kërkesëpadi do të kërkohej edhe konstatimi i diskriminimit për shkaqet e cituara në ankesën e depozituar pranë KMD-së.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD mbajti kontakte me e-mail znj. B.G., ku në vazhdimësi iu kërkuar të dispononte një kopje të kërkesëpadisë së dërguar në gjykatë, ku të evidentohej fakti se çështja objekt ankese për konstatim diskriminimi ishte dërguar për t'u gjykuar gjyqësisht.
- Pas disa e-maileve të dërguara në adresë të KMD-së, znj. B.G. kërkoi që KMD të procedonte dhe të shprehej me vendim me aq fakte sa dispononte, lidhur me çështjen objekt ankese;
- Në këto kushte, për të marrë më tepër informacion lidhur me çështjen objekt ankese, në zbatim të Urdhërit nr. 45, datë 07.03.2022, të KMD-së, në datën 15.03.2022, pranë DRSSH Fier u krye inspektim, me qëllim verifikimin e pretendimeve të ankuesit N.G..

Objekti i inspektimit konsistonte në çështjet e mëposhtme:

- Informacion lidhur me mënyrën se si është llogaritur pensioni i ankuesit N.G. për periudhën kohore, gjatë së cilës ka kryer shërbimin ushtarak;
- Informacion mbi arsyet e mospërfitimit të Statusit të Naftëtarit nga ana e ankuesit N.G., duke analizuar vjetërsinë e tij në punë në këtë fushë sipas ndërmarrjeve ku ka punuar, me legjislacionin përkatës, përfshirë këtu VKM-në nr. 447, datë 3.6.2020 *“Për emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në VKM-në nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si: shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”.*
- Informacion lidhur me mënyrën e llogaritjes së pensionit të pleqërisë për ankuesin N.G., për periudhën kohore 1974-1981. Për sa më sipër, të jepen të dhëna lidhur me çështjet vijuese:
 - Duke u mbështetur në regjistrat dhe borderotë e pagave për këtë periudhë kohore, të jepet informacion mbi pozicionet e punës së ankuesit, duke kryer ballafaqimin përkatës me pozicionet e tij të punës të pasqyruara në librezën e punës. Të përgatitet një përmbledhje e borderove përgjatë këtyre viteve për ankuesin, sipas pozicionit të punës që ka patur.
 - Nëse ka mospërputhje, ndërmjet borderove dhe regjistrave të pagave, mbi pozicionin e punës së ankuesit, me shënimet respektive në librezën e tij të punës, të evidentohen me saktësi këto mospërputhje sipas viteve përkatëse dhe të tregohet se si është llogaritur pensioni i pleqërisë;
 - Informacion mbi koeficientin e përdorur për llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë për ankuesin N.G., për këtë periudhë kohore;
- Informacion mbi mënyrën e përlllogaritjes së pensionit të pleqërisë për ankuesin N.G. për periudhën kohore 2003-2016, përgjatë së cilës, ai ka patur statusin e invalidit të pjesshëm të punës. Të tregohet koeficienti i përdorur për të kryer përlllogaritjen përkatëse;

Gjatë inspektimit pranë DRSSH Fier, KMD mori në administrim informacionin e mëposhtëm:

Lidhur me çështjen e parë të objektit të inspektimit, inspektorët e KMD-së u bënë me dije nga personat përgjegjës të DRSSH Fier se z. N.G. e ka kryer shërbimin ushtarak përgjatë periudhës kohore 21.11.1970-16.11.1973. Në bazë të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, pensioni i pleqërisë së ankuesit, për këtë periudhë kohore llogaritet mbi bazën e pagës së pozicionit të punës që

ankuesi ka patur para se të fillonte shërbimin ushtarak. Për këtë periudhë kohore, masa e pensionit të pleqërisë është llogaritur me kategorinë B6 – specialist, duke mbajtur parasysh faktin se pozicioni i punës së ankuesit, para fillimit të shërbimit ushtarak ka qenë teknik-mekanik pranë NSHNG Fier.

Lidhur me çështjen e dytë të objektit të inspektimit, DRSSH Fier informoi se ankuesi nuk e përfiton shtesën e pensionit sipas statusit të naftëtarit, pasi ai nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë sipas nenit 6, germa b), të ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ku përcaktohet shprehimisht se shtesën mbi pensionin e pleqërisë e përfitojnë të gjithë personat, që kanë jo më pak se 6 vite punë, në profesione apo detyra sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, i ndryshuar, VKM-në nr. 447, datë 3.6.2020, si dhe VKM-së nr. 448, datë 03.06.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”. Lidhur me këtë çështje, përfaqësuesit e DRSSH Fier u shprehen se i kanë dërguar disa herë përgjigje zyrtare ankuesit, për ta qartësuar mbi procedurën dhe përlllogaritjen e kryer nga ky institucion. Ndërmarrja e Riparim-Furnizimit të Instrumentave të Shpimit (NRFISH) ose siç është quajtur ndryshe Ndërmarrja e Tubove Fier, nuk është përfshirë në listën e përcaktuar në VKM-të e sipërcituara. Kjo është edhe arsyeja përse ankuesi penalizohet dhe nuk përfiton shtesën në pension për statusin e naftëtarit.

Lidhur me çështjen e tretë të objektit të inspektimit, DRSSH Fier sqaroi se për periudhën kohore 1974-1981, duke u mbështetur në borderotë përkatëse, ankuesi rezulton se ka punuar në pozicionin e punës teknik mekanik pranë Bazës së Tubove Fier. Lidhur me shënimin e vënë në fund të faqes së librezës së tij të punës, ku citohet se ai ka punuar edhe difektoskopist, sqarohet fakti se si pozicioni “teknik mekanik” ashtu edhe pozicioni “difektoskopist” konsiderohen specialistë të mesëm dhe përlllogaritja e pensionit kryhet njëllor, sipas përcaktimeve të VKM nr. 561/2005. Koeficienti i përlllogaritjes së këtij pensioni është 8.59, që i përket vitit 2015.

Lidhur me çështjen e katërt të objektit të inspektimit, DRSSH Fier sqaroi se përgjatë periudhës kohore 2003-2015, ankuesi ka qenë invalid i pjesshëm. Për këtë periudhë kohore koeficienti i përlllogaritjes së pensionit ka qenë sërish i vitit 2015.

Ndër të tjera, personat përgjegjës pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, sqaruan se z. N.G. nuk është diskriminuar në asnjë rast nga ky institucion, pasi edhe persona të tjerë që janë ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme me të janë trajtuar njëllor. Në këtë kontekst, DRSSH Fier sqaron se edhe z. F.SH.A., i cili ka punuar pranë së njëjtës ndërmarrje (NRFISH) me ankuesin, i është kthyer e njëjta përgjigje lidhur me suplementin e pensionit, që ka lidhje me statusin e naftëtarit. Rast tjetër është edhe ai i z. B.LL., i cili për periudhën që ka punuar pranë Bazës së Tubove Fier, ose pranë NRFISH nuk e ka përfituar suplementin në pension, ndërkohë që për periudhën, që ka punuar pranë Uzinës së Përpunimit të Naftës Fier e ka përfituar shtesën përkatëse, pasi kjo uzinë përfshihej në listën e ndërmarrjeve përfituese.

Njëkohësisht, DRSSH Fier theksoi faktin se dosja e z. N.G. është dosje e kontrolluar dhe e audituar nga strukturat përgjegjëse, si dhe është dosje e çertifikuar nga ana e ISSH.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Mbështetur në nenin 31, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji.

Referuar nenit 32 të këtij ligji, pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

Sipas nenit 58 të ligjit të sipërcituar periudhat e sigurimit përfshijnë të gjitha periudhat: a) për të cilat janë paguar kontributet; b) gjatë të cilave është bërë pagesa nga sigurimet shoqërore, përfshirë edhe periudhën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove rezulton se ankuesi N.G., i datëlindjes 23.11.1950 ka dalë në pension në vitin 2015. Me vendimin nr. 4361, datë 18.12.2015, e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shqoërore Fier, z. N.G. i është caktuar pension pleqërie, për periudhën e sigurimit 44 vite e 11 muaj. Baza fillestare e vlerësuar, mbi të cilën është llogaritur pensioni është 27777 lekë. E drejta e pagesës ka filluar prej datës 23.11.2015. Pensioni i tij, i pleqërisë është llogaritur mbi shumën bazë, që është 8.585 lekë. Shtesa e pensionit kap vlerën 12481 lekë dhe masa e pensionit është 21067 lekë, pasi është llogaritur si shumë e shtesës së pensionit dhe shumës bazë.

Në llogaritjen e pensionit janë përfshirë periudhat e vjetërsisë, si më poshtë:

- Periudha 01.06.1966 – 31.08.1966 – NMSH Prodhim Marinëz, që është vlerësuar me pagën referuese “c4 nafta”, në shumën 3288 lekë;
- Periudha 03.09.1970 – 18.11.1970 – teknik mekanik/NSHNI, që është vlerësuar me pagën referuese b6-specialist në ndërmarrje, në shumën 3288 lekë;
- Periudha 21.11.1970 – 16.11.1973 – shërbimi ushtarak, që është vlerësuar me pagën referuese b6 - specialist në ndërmarrje, në shumën 3288 lekë;
- Periudha 01.06.1974 - 31.12.1981 – teknik mekanik/NBT, që është vlerësuar me pagën referuese b6-specialist në ndërmarrje, në shumën 3288 lekë;

- Periudha 01.01.1982-26.02.1993, punësuar pranë NRFISH, vlerësuar me pagën referuese “c4 nafta” në shumën 3288 lekë;
 - Periudha 26.02.1993-31.08.2003, vlerësuar me pagën referuese b6 specialist në ndërmarrje 3288 lekë dhe prej 01.01.1994 me pagat mbi të cilat është paguar kontributi i sigurimeve shoqërore;
 - 01.09.2003-23.11.2015 – invalid i pjesshëm;
- Lidhur me pretendimin e ankuesit, se përgjatë periudhës 21.11.1970 – 16.11.1973, kur ai ka kryer shërbimin ushtarak, pensioni nuk është llogaritur në masën e duhur, KMD ka kryer verifikimet përkatëse dhe gjykon se:

Në nenin 66, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Të ardhurat e fondit të sigurimeve shoqërore përbëhen nga:

- a) kontributet e personave të siguruar dhe e punëdhënësve të tyre;
- b) kontributet nga Buxheti i shtetit për personat që nuk mund të paguajnë kontribucione, veçanërisht për:
- shtetasit që shërbejnë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak;”

Në nenin 9, paragrafi 6, i ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se:

“Shteti pague kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike, të zhvilluar më parë, për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me Ligje dhe me Vendime të Këshillit të Ministrave.”

Mbështetur në Vërtetimin nr. 24/39 prot., datë 24.07.2015, e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, rezulton se z. N.G. ka kryer Shërbimin e Detyrueshëm Ushtarak Aktiv, nga data 21.11.1970, deri në datën 16.11.1973, në Repartin Ushtarak nr. 9515. Sipas verifikimeve të kryera, rezulton se vlerësimi i masës së pensionit të z. N.G. për këtë periudhë kohore, është kryer duke u mbështetur në pagën e pozicionit të punës, që ai ka mbajtur para kryerjes së shërbimit ushtarak, pasi për periudhën kohore, që ai ka kryer këtë shërbim, shteti ka derdhur kontribute në bazë të pagës së pozicionit të punës që ankuesi ka mbajtur para se të fillonte shërbimin ushtarak. Referuar librezës së punës së z. N.G., rezulton se përgjatë periudhës 03.09.1970-18.09.1970, ka punuar në pozicionin e punës teknik mekanik pranë N.SH.N.R. Fier, e në vijim është shkëputur nga puna për të kryer shërbimin ushtarak. Në këtë kontekst, masa e pensionit është vlerësuar nga DRSSH Fier, me pagën referuese b6 - specialist në ndërmarrje, në shumën 3.288 lekë.

- Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk ka përfituar suplementin e pensionit të pleqërisë për periudhën 01.06.1974 - 31.12.1981, ku ai ka punuar pranë Ndërmarrjes së Tubove të Naftës Fier, rezulton se:

Mbështetur në aktin “Diplomë” të Shkollës së Mesme Industriale “7 Nëndori”, rezulton se ankuesi N.G. ka fituar titullin Teknik i Mesëm Mekanik.

Në bazë të informacionit të dhënë nga DRSSH Fier rezulton se sipas borderove të pagave dhe regjistrave përkatës, përgjatë periudhës 01.06.1974 - 31.12.1981, ankuesi N.G. ka punuar në pozicionin e teknikut mekanik, fakt që rezulton edhe në librezën e tij të punës. Në fund të faqes 7 të librezës së punës, (jashtë pjesës tabelore, ku bëhen shënimet mbi pozicionet e punës nga ana e punëdhënësit) është bërë një shënim, sipas së cilit prej datës 01.09.1975, ankuesi ka punuar në pozicionin e punës difektoskopist pranë së njëjtës ndërmarrje. DRSSH ka sqaruar se sipas borderove, ankuesi ka punuar teknik mekanik pranë Ndërmarrjes së Tubove Fier. Një fakt i tillë vërtetohet edhe në aktin “Akt Verifikimi” i vjetërsisë në punë para vitit 1994”, i cili është mbajtur në datën 17.12.2015, në Arkivin e DRSSH Fier, ndërmjet inspektorit verifikues z. I.R. dhe arkivistës së karrierës znj. L.M., për verifikimin e vjetërsisë në punë të z. N.G.. Akti i verifikimit është kryer në regjistrat themeltarë, në bordero, në libra pagash, libër indeksi, që ndodhen në arkivin e DRSSH Fier. Sipas regjistrat themeltar rezulton se ankuesi ka punuar pranë Albpetrol sh.a. Patos, në disa ndërmarrje, ndërmjet së cilave edhe pranë Bazës së Tubove Patos, Fier, ku ka mbajtur pozicionin e punës “teknik mekanik”.

Në vitin 2019, është miratuar ligji nr. 29/2019 *“Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”*. Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar i punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, *“Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”*, të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, *“Për Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.⁶

Në bazë të nenit 13, të ligjit nr. 29/2019 *“Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”*, ku parashikohet: *“Përfitimi, sipas përcaktimeve në këtij ligji, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij ose pranë sporteleve të shërbimit në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit, së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe rregulloreve të ISSH-së”*, ankuesi N.G. ka aplikuar për pension suplementar (naftë dhe pleqëri), nëpërmjet kërkesës së tij me shkrim nr. 359 regj., datë 11.09.2019, të depozituar pranë DRSSH Fier.

Në nenin 2, të ligjit të sipërcituar parashikohet se: *“Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat në profesione e punë, në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji, që u njihet vjetërsia në punë dhe periudha e sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 3, të këtij ligji, e që njëkohësisht plotësojnë edhe kushtet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, si më poshtë:*

⁶ Referuar nenit 1 të ligjit nr. 29/2019 *“Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”*;

- a) pensionistët, të cilët kanë përfitur pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) pensionistët, të cilët kanë përfitur pension sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;
- c) punonjësit, të cilët kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë;
- ç) punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës;
- d) punonjësit që kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë dhe ndërmarrje, sipas përcaktimeve në krerët III, VIII e XII, të pasqyrës nr. 1, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar.”

Në nenin 3 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: “Personave të përcaktuar në nenin 2, të këtij ligji, u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si më poshtë:

- a) pension për shkak të profesionit (llojit të punës);
- b) shtesë mbi pensionin e pleqërisë;
- c) shtesë mbi pensionin e invaliditetit.”

Përfitimet e sipërcituara kushtëzohen nga përmbushja e 6 viteve vjetërsi në punë e personave që kanë punuar në profesionet e sipërcituara. Kështu, në nenin 6, pika 1, gërmat a) dhe b) të ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji” parashikohet se: *1. Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë:*

a) ish-punonjësit, sipas përcaktimeve në këtë ligj, të cilët kanë përfitur pension pleqërie ose do të plotësojnë kushtet për të përfitur pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë shtesë pensioni për çdo vit periudhe sigurimi në profesion, sipas përcaktimeve në nenin 3, si më poshtë:

- i) punonjësit e nëntokës, 1 % të masës së pensionit të pleqërisë;
 - ii) punonjësit e industrinë së naftës e të gazit dhe punonjësit e metalurgjisë, 0,6 % të masës së pensionit të pleqërisë;
- b) shtesën mbi pension, sipas shkronjës “a”, e përfitojnë të gjithë personat që kanë jo më pak se 6 vite në profesionet dhe punët e përcaktuara në këtë ligj;

Në zbatim të ligjit të mësipërm janë miratuar VKM nr. 447, datë 3.6.2020 “Për emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të

ndryshuar, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si: shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës” dhe VKM nr. 448, datë 3.6.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të Personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e Sistemit të Naftës”, ndërkohë që në fuqi është edhe VKM nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, i ndryshuar.

Referuar akteve të sipërcituara rezulton se Ndërmarrja e Tubove të Naftës Fier, ku ankuesi ka punuar përgjatë periudhës kohore 01.06.1974-31.12.1981, nuk përfshihet si ndërmarrje përfituese. Pra, punonjësit e kësaj ndërmarrjeje nuk mund të përfitojnë nga suplement në pension, në bazë të ligjit nr. 29/2019. Një fakt i tillë është pasqyruar edhe në aktin Vërtetim i Posaçëm Zyrtar nr. 7026 prot., datë 19.02.2020, të DRSSH Fier, “Për llojin e punës/profesionin në zbatim të ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Referuar aktit të sipërcituar rezulton se ankuesi N.G. ka punuar në profesione apo detyra që mbulohen nga përcaktimet e VKM-se nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar, përgjatë periudhës kohore 01.06.1966-31.08.1966, në pozicionin e punës “pompist” pranë N.M.SH. Prodhim Marinëz.

Ndërkohë që sipas këtij vërtetimi, ankuesi nuk ka punuar në punë, profesione apo detyra sipas përcaktimeve të VKM nr. 447, datë 03.06.2020 dhe VKM nr. 448, datë 03.06.2020.

Referuar vërtetimit të sipërcituar rezulton se punë të tjera në Industrinë e Naftës, të cilat janë të paparashikuara si punë/detyra të vështira në aktet e sipërcituara janë:

Nr.	Ndërmarrja /institucioni	Lloji i punës/detyra	Fillimi i marrëdhënieve të punës	Përfundimi i marrëdhënieve të punës
1.	Ndërmarrja e Bazës së Tubove Patos	Teknik Mekanik	01.06.1974	31.12.1981
2.	N.R.F.I.SH Fier	Difektoskopist	01.01.1982	08.02.1984
3.	N.R.F.I.SH Fier	Ndjekës Komplet	09.02.1984	08.05.1984
4.	N.R.F.I.SH Fier	Kontrollor kanterial	09.05.1984	26.02.1993
5.	N.R.F.I.SH Fier	Brigadier Kontrollor	27.02.1993	30.05.1998
6.	N.R.F.I.SH Fier	Specialist kontrollor i brendshëm	01.06.1998	31.08.2002

Në këtë kontekst, rezulton se Ndërmarrja e Bazave të Tubove dhe NRFISH (Ndërmarrja e Riparimit dhe Furnizimit të Instrumentave të Shpimit) nuk janë përfshirë në listimet e VKM-ve të sipërcituara, si ndërmarrje përfituese nga ligji nr.29/2019.

Në këto kushte, DRSSH Fier i ka dërguar përgjigje ankuesit nëpërmjet shkresën nr. 2172 prot., datë 19.02.2021, ku e informon se ai nuk mund të jetë përfitues pasi nuk plotëson vjetërsinë në punë (6 vjet) për të përfituar shtesën në pension, sipas nenit 6, pika 1, gërma b), të ligjit nr. 29/2019.

Nga aktet e administruara në cilësi prove rezulton se DRSSH Fier e ka sqaruar z. N.G. edhe nëpërmjet shkresave të tjera të dërguara në adresë të tij, të tilla si, shkresa nr. 6109/1 prot., datë 09.07.2021, dhe shkresa nr. 8910 prot., datë 28.09.2021, e këtij institucioni.

Njëkohësisht, rezulton se edhe dy punojësve të tjerë, të cilët sikurse z. N.G. kanë punuar pranë Ndërmarrjes së Tubove të Naftës, Fier, nuk u është njohur e drejta për shtesë në pension⁷, në bazë të ligjit nr. 29/2019, pasi kjo ndërmarrje nuk përfshihej në listën e ndërmarrjeve përfituese. Kështu, z. F.SH.A., i cili ka punuar pranë së njëjtës ndërmarrje me ankuesin, i është kthyer e njëjta përgjigje lidhur me suplementin e pensionit, në bazë të ligjit të sipërcituar. Rast tjetër është edhe ai i z. B.LL., i cili për periudhën që ka punuar pranë Bazës së Tubove Fier ose pranë NRFISH nuk e ka përfituar suplementin në pension, ndërkohë që për periudhën, që ka punuar pranë Uzinës së Përpunimit të Naftës Fier e ka përfituar shtesën përkatëse, pasi kjo uzinë përfshihej në listën e ndërmarrjeve përfituese.

Ankuesi e ka ankimuar pensionin e caktuar nga ana e DRSSH Fier pranë Komisionit Rajonal të Ankimit. Ky i fundit pas kryerjes së verifikimeve përkatëse është shprehur me Vendimin nr. 923, datë 12.11.2021, nëpërmjet së cilit ka rrëzuar kërkesën e ankuesit N.G. dhe ka lënë në fuqi Vendimin e DRSSH Fier.

Kundër Vendimit nr. 923, datë 12.11.2021, të Komisionit Rajonal të Ankimit, z. N.G. ka bërë ankimin e datës 11.03.2022, pranë Komisionit Qëndror të Ankimit, Tiranë. Nga informacioni i administruar nga strukturat përgjegjëse të DRSSH Fier, dosja e ankuesit do të përcillet për shqyrtim administrativ pranë këtij Komisioni, sipas parashikimit nenit 86, të ligjit nr.7703/1993 *“Për sigurimet shoqërore në RSH”*, të ndryshuar.

➤ Lidhur me llogaritjen e masës së pensionit përgjatë periudhës 01.09.2003-23.11.2015, kur ankuesi ka qenë invalid i pjesshëm.

Referuar Dëshmisë së Invaliditetit nr. 128, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës, ankuesi është invalid i pjesshëm pune. Për arsye shëndetësore, z. N.G. është shkëputur nga marrëdhëniet e punës përgjatë periudhës kohore 01.09.2003-23.11.2015, pasi ka gëzuar statusin e invalidit të pjesshëm të punës, grupi IV. Përgjatë kësaj periudhë kohore, ai është trajtuar me pension invaliditeti.

Me Vendimin nr. 186/1, datë 18.12.2015, e DRSSH Fier, pensioni i invaliditetit që ankuesi përfitonte është ndërprerë, pasi ai ka mbushur moshën për pension pleqërie. Periudha e përfitimit të pensionit të invaliditetit është pasqyruar në bazën e vlerësuar mesatare për efekt pensioni, me koeficientet e vitit 2015, sipas listimit për vitet përkatëse. Për efekt të bazës së

⁷ Referuar shkresës nr. 6038 prot., datë 09.12.2020, të DRSSH fier, shkresës nr.14378 prot., datë 21.12.2020, e DRSSH Fier dhe shkresës nr. 5476, datë 16.11.2020 të DRSSH Fier.

vlerësuar është përdorur paga minimale e vitit përkatës, shumëzuar me koeficientin e vitit. Kjo mënyrë është përdorur në të gjitha përfitimet e këtij lloji deri në vitin 2015. Për sa më sipër, referuar informacionit të administruar nga ana e DRSSH Fier, rezulton se përlllogaritja për përcaktimin e masës së pensionit për këtë periudhë kohore, është kryer mbështetur në koeficientin e vitit 2015, që është 8.59.

Në këtë kontekst, bie pretendimi i ankuesit se për përlllogaritjen e masës së pensionit të tij nuk është përdorur koeficienti i duhur.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e DRSSH Fier.

Në mungesë të këtij trajtimi, nuk ka diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të “moshës” dhe “aftësisë së kufizuar” të z. N.G., nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Të mira e shërbime
Shkak – mosha, aftësia e kufizuar
Lloji i vendimit - mosdiskriminim